



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:172306
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05479875

Ac.nr.8409/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Malsor Kryeziu, anëtar të kolegjit, në procedurën kontestimore të paditësit S.G., nga fshati D....., Komuna Suharekë, të cilin me autorizim e përfaqëson Z.B., avokate nga Ferizaji, kundër të paditurës Komuna e Suharekës, Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensim të shujtave ditore, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësueses të autorizuar të paditësit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, C.nr.833/2021 të datës 24.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hudhet ankesa e paditësit S.G., nga fshati D....., Komuna Suharekë, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, C.nr.833/2021 të datës 24.10.2022, si e pas afatshme.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin C.nr.833/2021 të datës 24.10.2022, në dispozitiv e ka hedhë poshtë padinë me numër C.nr.833/2021 e dorëzuar pranë asaj gjykate më datë 04.08.2021 nga ana e përfaqësuesit me autorizim të palës paditëse av. Z.B., nga Ferizaji, kundër të paditurit Komuna e Suharekës, Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti për kompensim të shujtave ditore.

Kundër këtij aktvendimi, ankesë ka ushtruar e autorizuar e paditësit av. Z.B., për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes së ligjit material, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën dhe të anuloj aktvendimin e atakuar, duke e urdhëruar gjykatën e shkallës së parë që të vazhdoj me seancë të shqyrtimit përgatitor.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

- *Ankesa e të autorizuarës të paditësit është e pa afatshme.*

Gjykata e Apelit duke vlerësuar lejueshmërinë e ankesës së ushtruar nga e autorizuar e paditësit, e paraqitur kundër aktvendimit të ankimuar të nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë, C.nr.833/21, i datës 24.10.2022, ka konstatuar se ankesa është paraqitur pas kalimit të afatit kohor të dhënë në këshillën juridike të aktvendimit të atakuar prej 15 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit në dorëzim të të njëjtit aktvendim nga e autorizuar e paditësit.

Tek një përfundim i tillë kjo gjykatë vjen për faktin se me shikim në flet kthesën e cila gjendet si dëshmi në shkresat e lëndës konstatohet se e autorizuar e paditësit av.Z.B., nga Ferizaji, aktvendimin e ankimuar e ka pranuar në mënyrë të rregullt me datën 01.11.2022, ndërsa ankesën kundër të njëjtit aktvendim e ka dorëzuar në gjykatë me datë 17.11.2022, rrethanë kjo e cila vërtetohet nga vula e pranimit të gjykatës së shkallës së parë, e cila është vendosur në ankesën e dorëzuar tek e njëjta gjykatë, tek zyra e pranimit me konstatimin se: Z.B., me datën 17.11.2022 në ora 13:19, dorëzoi këto dokumente: Ankesë.

Afati kohor ligjor për ushtrim të ankesës ka qenë afati prej 15 ditësh, i cili ligjërisht ka filluar të rrjedhë nga dita e nesërme prej kur e autorizuar e paditësit e ka pranuar aktvendimin e ankimuar, që në rastin konkret i bie të ketë filluar nga data 02.11.2022, e ku me shikim në kalendarin mujor – nëntor, për vitin 2022, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e ankesës – duke marr afatin e dhënë në këshillën juridike ka qenë data 16.11.2022, datë kjo kur edhe ka skaduar afati kohor i dhënë në këshillën juridike prej 15 ditësh. Meqë dita e fundit për paraqitjen e ankesës - pra data 16.11.2022 sipas kalendarit ishte ditë pune, atëherë afati i fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë kjo ditë- e mërkurë, ndërsa e autorizuar e paditësit ankesën e ka paraqitur me datë 17.11.2022 dhe e ka dorëzuar në gjykatë me këtë datë, e njëjta është jashtë afatit të përcaktuar prej 15 ditëve.

Afatet kohore të përcaktuara me ligj, janë të pandryshueshme dhe nuk mund të zgjaten apo shkurtohen as me vendim të gjykatës e as me marrëveshjen e palëve. Afati ligjor ka karakter prekluziv, sepse veprimi procedural i lidhur për afatin ligjor nuk mund të kryhet pas skadimit të tij.

Gjykata e Apelit në kuptim të rrethanave të paraqitura më lartë gjen se ankesa është e pa afatshme pasi që me dispozitën e nenit 186 paragrafi 2 i LPK-së, përcaktohet se: *“Ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”*, ndërsa me dispozitën e nenit 196 përcaktohet se: *“Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në nenin 186 të LPK-së”*.

Në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë provë me të cilën do të konfirmohej se ankesa është dorëzuar në ndonjë datë tjetër, prandaj nga arsyet e mësipërme, Gjykata e Apelit e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që gjeti se ankesa e paditësit është e pa afatshme, të cilën kjo gjykatë e hedhë poshtë në pajtim me nenin 186 paragrafi 2, 196 dhe 209 pika (a) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8409/2022, me datë 19.03.2024

Kryetarja e Kolegjit
Naime Ahmeti, d.v